



Në shtëpinë e Lindës dhe Edit

Nga Arta Marku

Mjaft të kapërcesh derën e apartamentit të Një-shit të socialistëve, për të kuptuar se kureshtja paskësh qenë e përligjur. Aq më tepër që nuk bëhej fjalë për një kureshtje që gërvisht gjithkënd, me idenë për të zbuluar detajet e mjedisit në të cilin jeton një person i njohur me të shoqen. Më shumë se kaq, ishte një lloj besimi se përtej gjendeshin detaje të pazakonta, unike. Dhe ashtu qe. Në atë hapësirë të organizuar për t'i krijuar vetes komoditet, gjeje detaje specifike domethënëse për banorët e saj... E kuqe që ndihmon energjinë, e gjelbër që nxit meditimin. Po, këto ngjyra binin fort në sy. Porse e pazakonta qëndronte në detaje të tjera, që zbulohen një nga një, pas shikimit të parë të shpejtë.

Me të kapërcyer kuadratin e derës, depërtoje brenda dritës që mbushte atë hapësirë unike banimi. Shumë dritë që vinte nga vetrata e madhe sa i gjithë krah u gjatësor i banesës. Një dritë e nevojshme sidomos për stinën e dimrit, e ndihmuar tepër prej orientimit nga jugu. Majtas, këndi i ndenjes thjesht funksional. Kolltuku i Ramës, i gjelbër, por mbi të gjitha i rehatshëm. Djathtas, tryeza e ngrënies për 8 persona, e kuqe. Ndoshta, detaji i parë që binte në sy për pazakonshmërinë.

Asgjë të përbashkët me tryeza ngrënieje që mund t'i gjesh ngado, nëpër banesa luksoze apo modeste, moderne apo etnike... asgjë të përbashkët me tryezat e restoranteve që zgjedhin të të joshin herë me dizajn klasik e herë rustik... Mund të gjendej vetëm aty, në atë apartament të përmbytur nga drita, në katin e fundit të një pallati të ri përballë Drejtorisë së Policisë. Të tetë karriget qenë të ndryshme, në formë dhe ngjyrë. Një e gjelbër, një e bardhë, dy a tri të tjera gri dhe po aq të kuqe. Njëra me krahë për të mbështetur bërrylat e një tjetër thjesht me shpinore. Mbi tryezë, veç luleve, një mulli piperi tejet i madh dhe i kuq. Nuk e kishte harruar Linda nga darka e shkuar. Dekor? Pyes zonjën e shtëpisë. Kurse ajo buzëqesh: “Jo, pjesë e domosdoshme e tryezës. Është një nga përbërësit e gatesave që Edi nuk harron kurrë ta përdorë”.

Tek syri kalon në detajet e tjera të shtëpisë, është e lehtë të kuptosh se ka shumë që ngacmojnë kureshtjen dhe nxisin pyetje. Po këto këpucë në bibliotekë?! Kafe e errët. Takat tepër të larta, ngjajnë me dy skulptura të gdhendura në një akull që nuk shkrin kurrë. Linda më rrëfen (ndoshta nuk e dinte se doja ta bëja publik këtë detaj). Janë këpucët e dasmës. I ka veshur vetëm gjatë ceremonisë së stërmadhe kur shkëmbyen unazat në tetorin e dy viteve të shkuara. Sakaq janë shndërruar në një lloj simboli, në një relik. Veçse jo vetëm për ceremoninë në të cilën i ka përdorur, por edhe për faktin tjetër (tejet i rëndësishëm ky): janë dhuratë e së bijës, Reas. Në krah të këpucëve në të njëjtin raft, një shishe e pluhurosur vere: “Dhuratë e një mikut tonë të përbashkët. Vera ka moshën tonë”. Ishte prodhim i vitit 1964. E vetmja shishe, për shkak të domethënies së saj që ishte vënë veçmas të tjerave, që ishin me të vërtetë shumë në dy mbajtëse të posaçme shishesh, të vëna në dy cepa të këndit të ngrënies.

Në faqen e bardhë të murit mbi njërin prej divaneve, një pikturë e Edi Hilës (nga pikturat e Ramës, në mure ka vetëm dy, me korniza të bardha dhe paspartim, nga ato të kohës kur ishte kryetar bashkie dhe vizatonte më lapustila mbi shkresa, me të cilat më pas hapi një ekspozitë). Në krah të pikturës së Hilës, për të cilën Rama vetë ndihet tejet krenar, pasi mendon se është më e mira e ish-kolegut të tij, një foto. Koha ka lënë gjurmë mbi të, por e bën më joshës portretin bardhezi të një gruaje, mbi format e të cilit, drita ka luajtur në mënyrë të përkryer. “Aneta. – i përgjigjet Linda pyetjes sime të shprehur mesa duket me mimikë, apo me përqendrimin e gjatë mbi foto. – E gjeta në studion e babait të Edit”. (Më tregon se ka gjetur në atë studio, gjatë vajtje-ardhjeve të saj të herëpashershme, sa e sa gjëra interesante. I ka marrë, duke i dhënë një lloj kënaqësie edhe nënës së burrit të saj, e cila nuk ka guxuar kurrë ta kapërcejë derën e studios së të shoqit, që pas ikjes së tij nga bota e të gjallëve). Nën foton bardhezi të Aneta Ramës (sipas Lindës është

e Niko Xhufkës), mbi parket, thjesht e mbështetur pas murit, një tjetër. Me ngjyra kësaj here. Kishte një aftësi magnetike: tregonte, mbi një trotuar me kalldrëm të ngjashëm me trotuaret e bulevardit të Tiranës, rindërtuar shumë vite më parë, sipas modelit fillestar bërë nga italianët, një gjethe e vetme rënë nga pema që dukej si një palë buzë të kuqe gruaje. A thua se ishin prej vërteti, shkëputur nga fytyra e rënë mu mbi atë trotuar të ftohtë, gri. Ngjitur, një tjetër kornizë. Piktura e parë e Edi Ramës, të cilën e ëma ia ka ruajtur, kushedi e ç’viti është. Kurse një pikturë e Gregut, që djali e ka bërë dhuratë për Edin & Lindën, është ende e mbështjellë tub në pritje për t’u vënë në kornizë. E ndoshta, meqë nuk është piktura e Gregut në mur, nuk është as ndonjëra prej pikturave të Reas, me të cilat Linda ka dekoruar të gjitha hapësirat e mureve të zyrës së saj.

Në bibliotekë, vetëm në raftin e sipërm disa libra arti. Fare pak tituj kanë të bëjnë me letërsinë, apo të tjera kësisoj, veç në mos blerjet e fundit, siç mund të jenë disa prej librave të panairit të nëntorit. Mbretëron argumenti politik. Në anglisht, frëngjisht apo italisht plot tituj librash politikë, studime apo analiza... dhe biografi të protagonistëve e politikës botërore bashkëkohore: Toni Blair, Bill Clinton, George Bush... Siç më thotë Linda, përmasat relativisht të vogla të bibliotekës në këtë shtëpi, kanë privuar tituj pafund librash, qoftë të sajat apo qoftë të të shoqit, që janë detyruar t’i mbyllin nëpër kuti. Kanë bërë një përzgjedhje sipas nevojave të momentit, ndaj dhe bien fort në sy në bibliotekë (që veçse për të mbajtur libra, ka edhe funksionin e ndarjes së zonës së ditës nga ajo e natës) librat e trashë të politikës (mes tyre edhe “Kurbani”, pa dyshim). Revistat kanë tejmbushur një tavolinë të gjatë dhe të ulët. Sepse banorët e kësaj shtëpie nuk i shpërfillin, mesa duket. Por më krijohet përshtypja se ajo është “zona” e Lindës. Jo thjesht për praninë e ca pak revistave femërore, por më shumë për titujt e revistave ekonomike, kryesisht “The economist”, që nisur nga profesioni, besova se janë të sajat. Nuk e pyeta se kush i ka sjellë në shtëpi, hamendësova se gjithsesi i interesojnë edhe një politikani të tilla revista. Kurse për disa qindra disqe që janë renditur në një tjetër raft, ma thotë vetë Linda që janë të sajat, madje me njëfarë keqardhjeje, për faktin se shumë më tepër se ç’janë aty, i është dashur, ashtu si librat, t’i mbyllë në kuti, në pritje që t’i hapë kur të zhvendosen në shtëpinë tjetër me të cilën gruaja prej disa vitesh po merret, por që do ende kohë të përfundojë...

Në këtë ndërkohë të qëndrimit tonë në shtëpinë e Lindës dhe të Edit (të cilën gruaja e ka gjetur të konceptuar qysh më parë nga i shoqi, por pa asnjë peng për shkak të mospjesëmarrjes së saj në arredim, ngase i pëlqen shumë) telefoni bie herë pas here apo lajmëron nëpërmjet sinjalit të ndonjë mesazhi. Në më të shumtat e rasteve, merret vesh qartë, është i shoqi. Ndodh kjo, rregullisht çdo ditë, edhe nëse Linda është në zyrë duke punuar

apo duke shijuar një kafe në baret rreth punës... E thirri pra, edhe atyre orëve të gjata të qëndrimit tonë në shtëpinë e tyre, disa herë. Veç mundesha ta merrja me mend nga ëmbëlsimi i tipareve të fytyrës së gruas se çfarë i thoshte... Ndërsa ora i afrohej gjashtës së pasdites, dielli kishte rënë e bashkë me të edhe drita në shtëpi...

Dy vjet bashkëjetesë me Edi Ramën: si mund të përshkruhen me dy fjalë?


Me dy fjalë, siç më pyetët: harmoni e plotë. Ndihem me shumë fat që jeta e solli të njihesha e të lidhja jetën me Edin, i cili, përveç shumë të tjerash, është një burim i pashtershëm energjish pozitive.

Çfarë thotë rasti juaj: të kundërtat (që tërhiqen) apo përbashkësitë e mbajnë një çift të bashkuar?

Komplementariteti, apo shqip përputhshmëria (më erdhi në mendje intervista që pata bërë me Ramën një vit e gjysmë të shkuar, dhe shkëputa prejsaj fragmentin e mëposhtëm: në çift më tërheq përputhshmëria, e kuptuar si kompatibilitet mes të ndryshmish jo si ngjashmëri mes të njëjtësh. Dhe më mban komplotiteti, në një kuptim të bukur që në shqip s’jam i zoti t’ia gjej kësaj fjale, një lloj shkalle e posaçme ndërveprimi, sa racional aq edhe misterioz me një grua). Dashuria është vërtet ushqimi kryesor dhe i pazëvendësueshëm për të kaluar një jetë të lumtur në çift. Por besoj që lumturia bashkëshortore dhe harmonia familjare është shumë më tepër se kaq. Është mundësia për të lexuar në thellësi tjetrin, për të kuptuar natyrën, dëshirat, vlerat dhe pasionet. Kjo, mendoj, krijon edhe premisat për tolerancën e domosdoshme ndaj opinioneve dhe kritikave apo pakënaqësive të natyrshme të momentit. Nëse nuk e bën këtë, mund të ndodhë ta gjykoshtjetrin për gjëra që në të vërtetë duhen vlerësuar.

Mos do të thotë kjo që të jesh në funksion të tjetrit?

Jo, aspak. Gjithnjë duhet të ekzistojë reciprociteti. Të jeniebindur,Ediështënjëlexuesithellëinatyrave njerëzore. Ka një intuitë të jashtëzakonshme, një aftësi të penetrimit psikologjik. Dhe është tolerant deri në fund për t’u marrë me tjetrin në procesin njohës. Kjo ndodh me fëmijët. Ata vetë çuditen kur ai flet me ta dhe i përshkruan karakteret deri në thellësi, ashtu siç janë në të vërtetë.



A është kjo bashkëjetesë përmbushja e pritshmërive tuaja? A e kishit imagjinuar kështu? A ka të papritura?

Pritshmëritë e mia janë ato që çdo grua apo nënë ka për familjen. Ndërsa të papriturat, në kuptimin më të mirë të fjalës, si ngjarje familjare që e bëjnë jetën aspak monotone, janë të garantuara me një njeri si Edi që s’e duron dot rutinën. Një nga ngjarjet më interesante të bashkëjetesë sonë, ku hyn në mes e papritura, ishte procesi i të shkruarit të “Kurban”-it. Ka qenë shumë emocionuese për mua, kënaqësi e shtrirë në dy muaj të jashtëzakonshëm pas përfundimit të zgjedhjeve në Tiranë. E kam jetuar si privilegj të qenit pjesë e brendshme e procesit të atij libri që, po të mos isha në “konflikt interesi”, do ta komentoja me orë si një kënaqësi e posaçme në shumë këndvështrime.

Po pritshmëri apo të papritura “të vogla”, ato që mbushin përditshmërinë?

Padyshim që ka. Të papritura jo vetëm të këndshme, por edhe nga ato që meritojnë të ruhen në “arkivën” e memories. Sërisht do ta lidh me librin. U mora unë me ftesat e promovimit të librit, për ta lehtësuar Edin nga kjo ngarkesë e panevojshme. Ia dërgova pakon e ftesave të shtypura në zyrë. Vetëm pak minuta më pas marr një telefonatë nga dikush që më thotë: “Kam një porosi nga Zoti Rama për ju”. Dhe më mbërrin menjëherë njëra prej ftesave, me një dedikim shumë “atipik” të shkruar prej tij.

E keni ruajtur?

Pa dyshim.

Pavarësisht këtyre që thoni, përfytyrohet e vështirë të jetuarit me një politikan.

Edi është mjaft atipik për të shërbyer për çfarëdo përgjithësi si ky që më kërkon. Por në të gjitha rastet do të ishte i pamundur, sepse politikanët janë si gjithë të tjerët, njerëz që ndryshojnë nga njëri-tjetri. Dhe s'do habitesha fare sikur të mësoja se shumëkush ndër ata që, për së largu, nga ekrani, të krijojnë një përshtypje të caktuar, përgjithësisht negative për shkak të cektësisë e të ashpërsisë në komunikim, në jetën e tyre familjare të jenë krejt ndryshe. Çka mund t'ju them me siguri është, se politika e ditës nuk e kapërcen derën e shtëpisë sonë. Pa dyshim, ne flasim edhe për politikën, Edi e ka pasion, por shkak për të folur bëhen ngjarjet e veçanta brenda dhe jashtë vendit, jo pjesa që ka të bëjë me të përditshmen. E përditshmja prodhon shumë politikë, mirëpo ka diçka që nuk shkon në përgjithësi apo që mua nuk më shkon, prandaj shmangem nga përfshirja në këtë prodhimtari, sepse ndihet rëndom dasia, irracionaliteti apo pushteti i padurueshëm i thashethemit e i lojës së fajësimit me tifozllëk, jo me argument, të atyre që i fusim rëndom në të njëjtin thes vetëm sepse quhen politikanë. Sidoqoftë, pa iu shmangur pyetjes suaj, mund të them se unë nuk jetoj me një politikan në kuptimin e thjeshtë, apo edhe rëndues që ka kjo fjalë në mjedisin tonë. Jetoj me një njeri që politikën e ka pasion, jo zanat, ashtu siç ka pasion artin, letërsinë, filmat apo bisedat për jetën e për botën ku jetojmë.



E megjithatë flisni... Ndikuese, imponuese... Jeni ju e tillë?

S’dua ta fsheh që unë nuk ndërhyj asnjëherë në punën e përditshme të Edit, jo vetëm sepse parimisht s’më pëlqen të ndërhyj në detajet e punës së tij, po edhe sepse besoj që nuk do ta ndihmoja duke marrë rol në këtë drejtim. Sepse puna që unë bëj është apartiake. Unë merrem me punë studimore në fushën ekonomike e sociale dhe këshilloj, sipas kërkesës, institucione ndërkombëtare për këto fusha. Kjo më jep mundësinë që shumë zhvillime jo vetëm t’i studioj, por edhe t’i prek përmes perceptimit të njerëzve, duke konsoliduar apo modifikuar opinionet e mia për mënyrën se si po shkojnë ose duhet të shkojnë gjërat në shoqërinë tonë. Këto opinione, sigurisht, i diskutojmë dhe dëgjohemi me shumë dëshirë me Edin për të kuptuar sa më mirë pse-në e gjërave që shkojnë keq dhe për t’u këshilluar se si gjërat mund të bëhen më mirë.

Deri në ç’masë është vetë Rama i hapur ndaj këshillimeve në familje?

Nëse është e zakonshme për çdo burrë të vetëdijshëm për vlerat e pazëvendësueshme të këshillimit në familje, që të këshillohet me njerëzit e familjes duke dhënë e marrë mendime me ta, për çdo shqetësim që e mundon, Edi nuk bën përjashtim. Madje besoj se kam të drejtë po të them që Edi është ky që është edhe sepse është lindur e rritur në një familje ku ka pasur baraspeshë, respekt dhe mirëkuptim të ndërsjellë mbështetur mbi tolerancën e jo mbi diktatin. Atë që ai tregon për këtë në libër, unë kam pasur mundësinë ta jetoj në mënyrën e të qenit dhe përmes kujtimeve të nënës së tij të mrekullueshme.



Le të hyjmë më thellë, pushtetin në familjen tuaj kush e ka?

Në familjen tonë pushteti i përket përgjegjësisë së përbashkët dhe vetëdijes sonë, por edhe të fëmijëve tanë, se askush nuk ka të drejtë apriori. Është kënaqësi, fjala vjen, të ndjekësh debatet për kundërshtitë mes Edit dhe Gregut apo Reas, ku përgjithësisht arrihet në fund dakordësi e plotë kur bëhet fjalë për vërejtjet tona ndaj tyre. Por, jo një herë ka ndodhur të fitojnë ata, mes të qeshurave të përbashkëta, kur bëhet fjalë për çështje që natyrshëm i kundërvënë brezat në këto kohë kur të rinjtë kanë shumë informacion dhe opinione sfiduese.

Diku kam lexuar a dëgjuar për aftësitë e Edi Ramës në kuzhinë... kujt i takon kjo pjesë në shtëpinë tuaj?

Shpeshherë i them Edit me të qeshur, se kur të mos merret më me politikë do të jetë i detyruar të gatuajë për të gjithë njerëzit që ftojmë, sepse është një kuzhinier fantastik. Sot ndodh rrallë që ai të marrë në dorë tiganin apo tenxheret, po kur ndodh është “ngjarje” në aspektin kulinar dhe kujt i bie të jetë atë rast në shtëpinë tonë, merr kënaqësi të veçantë nga ushqimi. Pjesën tjetër, atë të përditshmen, e kam unë dhe besoj se i meritoj komplimentet e Edit përpara se të ngrihet nga tryeza.

Pra, ai i jep rëndësi këtij aspekti?

Po, gjithnjë, dhe e ka fare të natyrshme këtë gjë. Çdoherë që Edi ulet në tryezë, është i vëmendshëm të tregojë për të shijuarit. Dhe, jam e bindur, nuk e bën sepse ushqimi është i sofistikuar, thjesht e shijon dhe kënaqësinë që ndjen, do ta ndajë me atë që ia ka dhuruar. Unë vetë jam e tillë kur shijoj një gatesë, edhe në restorant.

A mund të na zbuloni ndonjë “mani” të Edi Ramës?

Ndoshta, fakti që është i dhënë pas detajit, fakti se beson që detaji përbën dallimin. Dhe pastaj, e ka të theksuar praninë. Në pamje të parë mund të duket sikur nuk e ka mendjen, është i përqendruar tek ekrani i TV-së, celulari, libri që po lexon apo vizatimi... por është kaq i vëmendshëm edhe ndaj gjithçkaje rreth e rrotull. Nuk shkëputet. Veprimit apo bisedës i vesh shpesh një tis ceremonial dhe cilësitë e tij bëjnë ta jetosh jetën cilësisht jo vetëm për vete, por edhe për tjetrin. Ndërgjegjshëm ose jo, e bën tjetrin të ndihet tejet mirë.

Rama, një nga burrat që dallon sa i përket veshjes. Fshiheni ju pas kësaj?

Nuk është e nevojshme. Qysh kur e kam njohur së largu, veç publicistikës, diçka tjetër që kam vlerësuar shumë tek Edi është aftësi për t'u veshur bukur, me një stil të vetin. Rezultat i prirjes së tij të brendshme për t'i dhënë vëmendjen e merituar pjesës estetike. Ndaj dhe nuk ka shumë për të sugjeruar. Por ndodh edhe të më kërkojë mendim në momente dyshimi në lidhje me zgjedhje të caktuara.



“Shtëpia e Edi Ramës”, një argument shumë i përfolur. Cilat janë projektet tuaja për një shtëpi “të vërtetë”?

Nëse ka një gjë që Edi me siguri nuk është, kjo ka të bëjë me kënaqësitë materiale. Edit nuk i bën asnjë përshtypje nëse jeton në një dhomë apo në një apartament të vogël me qira. Kështu ka qenë gjithnjë, siç tregon edhe e ëma dhe siç e njohin edhe miq të afërt prej kohësh. Apartamentin e ka dizenuar vetë dhe na ka krijuar mundësinë të jetojmë në një mjedis shumë të pëlqyeshëm, edhe pse vizitorët e shpeshtë befasohen që në atë hapësirë të vogël jeton pikërisht ai për të cilin çfarë nuk është thënë lart e poshtë. Ndërsa unë, edhe pse jam plotësisht e kënaqur me kushtet ku jetojmë, kam ëndërr të ndërtoj një shtëpi tonën. Dhe mundësitë që kam, ma lejojnë që këtë ëndërr ta realizoj. Me dëshirën e madhe që të kemi një shtëpi ku edhe fëmijët të mund të qëndrojnë për të fjetur kur vijnë, po edhe të mund të mblidhemi me miq pa u kushtëzuar nga hapësira.

Sa kohë kaloni me fëmijët tuaj?

Rea dhe Gregu janë fëmijë të rritur shëndetshëm, me kujdesin dhe dashurinë e prindërve dhe të

gjyshërve. Megjithëse tashmë të mëdhenj në shtat e të zhvilluar shumë në botën e tyre të të menduarit mes angazhimesh të përditshme, ata dinë ta vlerësojnë rolin tonë, si edhe faktin që mund të mësojnë shumë prej nesh. I kuptojnë mirë shqetësimet tona për ta, janë të vëmendshëm ndaj këshillave që u japim, konsultohen shpesh me mua, dhe kur kanë gjëra të rëndësishme e kërkojnë gjithnjë mendimin e Edit. Por, çka mua më bën shumë krenare, është se s’janë aspak të dhënë pas kotësive të kushtueshme, po shumë të thjeshtë dhe të mirësjellë në shtëpi e në mjedisin social. Talentet e tyre për artet apo arkitekturën i ndihmojnë shumë të jetojnë në një botë idesh e debatesh ku zhvillohen shpirtërisht e intelektualisht, edhe pse janë natyra të ndryshme që, fatmirësisht, shkojnë mrekullisht bashkë. Në kohë, kam kuptuar që aktivitetin e Edit e ndjekin me vëmendje, edhe pse kurrë nuk hyjnë me të në debate politike. Ndoshta jo sepse s’u pëlqen, po sepse, siç ma rrëfejnë mua ndonjëherë, e kuptojnë shumë mirë ngarkesën e tij, dhe kur e kanë në dispozicion u pëlqen të flasin me të për libra, art, arkitekturë, filma dhe aspekte të jetës sociale.

A mund të na bëni një vetëportretizim?

(Nuk do t’i përgjigjet kësaj pyetjeje. Beson se do të ishte më mirë t’ia bëja dikujt tjetër. Por pastaj fillon të artikulojë, duke e vënë veten në raport me të tjerët) Për këtë që jam, u jam mirënjohëse deri në fund të shpirtit dy prindërve të jashtëzakonshëm, që mua, vëllanë dhe motrën na rritën mes sakrificash të mëdha, me kujdes e dashuri, duke na edukuar me vlerat e njerëzve të ndershëm dhe punëtorë, të cilët e përballojnë jetën me dinjitet e harmoni familjare edhe kur jeta s’është bujare me ta në aspektin material. S’do isha kjo që jam, pa dyshim, po të mos kisha pasur edhe Rean e më pas Gregun. Që të dy më bëjnë të ndihem një grua e bekuar nga fati dhe më ndihmojnë ta jetoj kohën që ikën me mundësinë e të qenit edhe mikeshë e dy të rinjve të një kohe tjetër. Ndihem gjithaq e përkëdhelur nga fati për marrëdhënien shumë të afërt që kam me nënën e Edit, një grua shumë e rrallë, me kulturë e botë shpirtërore të pazakontë. S’do isha kjo që jam, nëse kultura e punës, mbjellë qysh në fëmijëri në shpirtin tim nga prindërit, s’do më kishte krijuar mundësinë e një zhvillimi akademik, përmes të cilit kam mundur të punoj shumë në fushën që kam pasion. Kam mësuar nga librat, por edhe nga puna, që më ka lidhur me njerëz të ditur apo të vuajtur; me profesorë dhe ekspertë të shquar këtu e jashtë vendit, apo me burra e gra të mençura nga zona të vështira të vendit; me njerëz të letrave e artit, apo edhe me njerëz të varfër. Pa të gjitha këto kontakte dhe eksperiencia njerëzore s’do isha kjo që jam.



Po Linda në aspektin femëror? Tek e fundit, ç'është feminiliteti për ju?

S'besoj se ka një shabllon për këtë, çështje shijesh them unë. Por, vetë mendoj se feminiliteti është eleganca femërore në paraqitje, sjellje dhe në komunikimin e mendimit. Stili i të qenit përtej asaj çka ka vizatuar natyra në pamjen e gruas. Është privilegj i veçantë kur e ndesh. Për të festuar Krishtlindjet ishim me fëmijët në Korçë, në një kompleks çlodhës. Më ka befasuar një fotografi bardhezi e viteve `30-të e varur në një prej mjediseve. Një grup grash korçare, duke biseduar në një oborr shtëpie në shoqërinë e një kafeje. Një feminilitet i admirueshëm, të cilin duke e soditur të bënte të ndiheshe mrekullisht mirë. Ose, si shikuese e pasionuar filmash, do të shtoja se feminiliteti për mua është Meryl Streep, e cila asnjëherë s'ka qenë një aktore e bukur në kuptimin e ngushtë të fjalës, por sot e gjithë ditën, kur mosha e saj s'është më ajo e njëzet a tridhjetë viteve më parë, mbetet një prezencë mbresëlënëse, që kur shfaqet i le në hije bukuritë sado mahnitëse fizike përreth saj.

Atëherë, ç'do të thoshit për aspektin estetik tek ju?

Aspekti estetik për mua është stil, vetidentifikim nëpërmjet tij. Jo luks apo shkëlqim. Mendoj se ashtu si një vepër arti, apo arkitekture, edhe njerëzit që kujdesen për estetikën e jashtme pasurojnë dekorin e qytetit. Dikush i veshur bukur, tek kalon në rrugë, më krijon idenë se e hijeshon atë rrugë. Ndërsa unë kam pasur gjithnjë një stil timin në veshje.

A bën Edi Rama dhurata?

Sigurisht. Bën dhe zgjedhjet e tij janë vërtet të veçanta, pasi Edi është shumë i dhënë pas simbolikës. Ndodh shpesh që miqtë që ftojme për darkë të largohen me një dhuratë nga Edi. Gjëra fare të vogla, të rastësishme, thjesht nga një ide që Edit i lind aty për aty, por që i bën shumë domethënëse momenti dhe mënyra se si Edi ua ofron.

Po ju? Çfarë konkretisht?

Vazhdimisht, dhe kjo është një pjesë e atyre të papriturave për të cilat folëm më lart.